



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**Legjislatura VIII**  
**Sesioni vjeshtor**

---

Komisioni për Punë të Jashtme dhe Diasporë  
Mbledhja nr. 12  
Prishtinë, më 12.11.2021, në orën 11:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

**P r o c e s v e r b a l**

**Në mbledhje morën pjesë:** Haki Abazi, Xhavit Haliti, Adelina Grainca, Dimal Basha, Fitore Pacolli-Dalipi, Ariana Musliu-Shoshi dhe Bahrim Shabani.

**Munguan:** Branislav Nikoliq, Gazmend Gjyshinca, Kujtim Shala dhe Time Kadrijaj,

**Në këtë takim ishte i ftuar:** z. Jörn Rohde, ambasador i Republikës Federale të Gjermanisë, me bashkëpunëtorin znj. Anna Stege.

**Pjesëmarrës të tjerë:** Haki Huruglica, MPJD; Arbenita Mjekiqi dhe Liridona Gashi, Kuvend-kabinet; Ermira Gashi, Kuvend; Agnesa Ismaili, KDI; Jon Krasniqi, PIPS dhe Shkumbin Halabaku, Kuvend.

**Stafi mbështetës i Komisionit:** Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

**Takimin e kryesoi:** Haki Abazi, kryetari i Komisionit.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 26 tetor dhe 2 nëntor 2021;
3. Takim me z. Jörn Rohde, ambasador i Republikës Federale të Gjermanisë, lidhur me liberalizimin e vizave;
4. Të ndryshme.

**3. Takim me z. Jörn Rohde, ambasador i Republikës Federale të Gjermanisë, lidhur me liberalizimin e vizave**

**Haki Abazi**, falënderoi ambasadorin për prezencën e tij dhe njoftoi se ky takim ka karakter të bashkëbisedimit dhe ngritjes së çështjeve të cilat janë në interes të dyanshëm. Abazi tha se e falënderon shtetin e Gjermanisë për përkrahjen e vazhdueshme për Republikën e Kosovës në të gjitha aspektet, si në të kaluarën ashtu edhe në të tashmen dhe shpreson që ky bashkëpunim do të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Prioritetet e Kosovës janë fokusuar në krijimin e vendeve të reja të punës dhe reformimin e sistemit të drejtësisë, por gjithashtu edhe aspiratat e qytetarëve të Kosovës për integrim në BE dhe në NATO, janë qëllimet kryesore të politikës së jashtme dhe angazhimit institucional në Kosovë. Këto dy tema, tha Abazi, se janë me interes për të parë pozicionin e Gjermanisë, marrëdhëniet bilaterale në raport me këto dy procese, ndihma dhe përkrahja që planifikohet për Kosovën në procesin e integritit evropian dhe anëtarësimin në NATO.

Një prej brengosjeve kryesore të institucioneve dhe qytetarëve të Kosovës tha se është mbetja e Kosovës jashtë zonës Shengen dhe lidhur me këtë kërkoi të njoftohet se si e sheh Gjermania përmbylljen e këtij procesi të tejzgjatur të liberalizimit të vizave.

Çështje tjetër aktuale, tha se është raporti me Serbinë dhe përfundimi i dialogut me një marrëveshje të plotë të normalizimit dhe njohjes së dyanshme. Lidhur me këtë Abazi shtoi se Kosova e ka marrë raportin e progresit dhe qasjen e institucioneve të BE-së, duke shtuar se ky dialog e ka futur Kosovën në një kurth sa i përket ecjes në procesin e integritit evropian. Për politikën e jashtme të Kosovës, tha se është e rëndësishme që të fillohet të mendohet në mënyrë të ndarë procesi i dialogut me Serbinë dhe proceset tjera integruese për Kosovën. Mungesa e vullnetit të Serbisë për të qenë aktor konstruktiv drejt finalizimit të procesit të integritit të Ballkani Perëndimor, nëpërmjet procesit të Berlinit, duke krijuar mekanizma tjerë, siç janë “Minishengeni” apo “Open Ballkan” e ka vështirësuar tutje qartësinë e rrugëtimit të Ballkanit Perëndimor në drejtim të BE-së.

**Jörn Rohde**, ambasador i Gjermanisë në Kosovë, falënderoi për ftesën dhe njoftoi se ka punuar në Komisionin për Punë të Jashtme në Bundestag, duke shtuar se e di se çfarë është e rëndësishme në mënyrë që parlamentarët ta shohin dhe të perceptojnë detyrën e tyre si kontroll ndaj Qeverisë.

Duke iu referuar pyetjeve të z. Abazi, lidhur me liberalizimin e vizave, tha se Gjermania e ka një qëndrim shumë të qartë dhe shumica e BE-së, e sheh në mënyrën e njëjtë se Kosova i ka plotësuar të gjitha parakushtet dhe se liberalizimi i vizave është vonuar. Ai përsëriti atë se çfarë ka thënë Heiko Maas, ministri i Jashtëm i Gjermanisë, gjatë vizitës së tij në Kosovë se qëndrimi i Qeverisë Federale është shumë i qartë, Kosova i ka përmbushur të gjitha kushtet dhe liberalizimi duhet të vijë. Ai më tej shtoi se kjo nuk është çështje nëse Kosova i ka përmbushur kushtet apo jo, mirëpo është çështje e besueshmërisë dhe se BE-ja duhet të jap atë që ka premtuar. Ai sugjeroi fillimin e bisedimeve në mënyrë dypalëshe me shtetet e tjera skeptike dhe se parlamentarët mund të kontribuojnë duke kontaktuar kolegët e tyre në parlamentet e ndryshme në BE.

Rohde njoftoi se Ambasada e Gjermanisë në Kosovë e ka zyrën më të madhe të vizave dhe se në kohën e pandemisë ka qenë zyra më e madhe në të gjithë botën sa i përket lëshimit të vizave; se në dhjetë vitet e fundit është dyfishuar personeli që punon në sektorin e vizave dhe se është zgjeruar ndërtesa e ambasadës me kontejnerë, në mënyrë që t’i bëhet ballë kërkesës së lartë për viza. Për shkak të pandemisë ka pasur shumë kërkesa të cilat janë grumbulluar dhe kjo ka ndikuar në shtimin më të madh të kërkesës dhe se në vitin e kaluar në kohën e pandemisë, janë lëshuar rreth 18000 viza për kategori të ndryshme. Ambasada Gjermane po e sheh çdo ditë si sfidë mungesën e liberalizimit të vizave, Gjermania është atdhe i një pjese të madhe të diasporës, sepse gjysmë milioni njerëz me origjinë nga Kosova, jetojnë në Gjermani.

Sa i përket integritit në BE dhe NATO, Rohde tha se Gjermania është një nga partnerët më të ngushtë të Kosovës sa i përket rrugës së saj në integritin euroatlantik dhe se kjo do të mbetet kështu. Gjermania përmes prezencës së fuqishme në Kosovë është donatori më i madh dypalësh, investitori më i madh, është partneri më i madh tregtar i Kosovës dhe se 43% të remitencave në Kosovë vijnë nga Gjermania. Sa i përket dialogut me Serbinë, tha se i kanë parasysh vështirësitë e dialogut dhe se Gjermania e mbështetë plotësisht dialogun e ndërmjetësuar nga BE-ja dhe z. Lajçak, sepse ai vepron në detyrë të të gjitha vendeve të BE-së, në mënyrë që të dy partnerët, pra Kosovën si shtet sovran ashtu edhe Serbinë si shtet sovran, t’i sjellë në një tavolinë për të biseduar. Marrëveshja që është arritur për tabelat e veturave paraqet një nga platformat në kuadër të së cilës mund të bisedohet dhe mund të arrihen rezultate.

Rohde, po ashtu, bëri të ditur se për Gjermaninë është e paimagjinueshme që një shtet të bëhet anëtar i BE-së nëse nuk e ka njohur një shtet tjetër dhe këtë e di edhe Serbia. Ai shtoi se duhet të ketë përparim dhe normalizim të dy shteteve, e kjo për Gjermaninë do të thotë në mënyrë shumë të qartë, njohje reciproke.

**Haki Abazi**, tha se diaspora e Kosovës në Gjermani është një urë e fuqishme e ndërlidhjes bilaterale dhe se Gjermania meriton falënderimin shumë të madh për integrimin e diasporës kosovare në Gjermani. Kosova tha se është një ndër vendet me inputin më të madh në tregun e punës në BE, dhe se kjo është thikë me dy tehe, në kuptimin që njerëzit duan të lëvizin, por në anën tjetër humbja e një pjesë të trurit për Kosovën është një çështje që kërkon adresim në aspektin zhvillimor.

Abazi pyeti lidhur me çështjen e përkrahjes së Gjermanisë në transformimin e FSK-së në ushtri, e cila është në drejtim të përbushjes së qëllimit për anëtarësim në NATO.

Lidhur me dialogun, tha se janë pajtuar për punën e dialogut në Bruksel, por kur kjo bëhet e stërzgatur e vendos atë në një plan të mbajturit peng në njërin anë, përderisa Serbia nuk e ka hequr Kosovën nga preambula e Kushtetutës së saj, që ka qenë zotim i vitit 2015, dhe ka vazhduar ta bëjë hapjen e kapitujve në integrim evropian.

Në anën tjetër, Kosova sikur gjykohet vetëm në perspektivën e dialogut me Serbinë dhe të gjitha proceset tjera shihen në dritën e dialogut. Kjo do të thotë që bashkëbisedimi nëpërmjet të cilit ne i rregullojmë të gjitha çështjet e hapura me fqinjët tonë, sikur është bërë një bllokadë konstante për proceset tjera për Kosovën. Dialogu po përdoret si një armë e fortë nga Serbia, për të parandaluar progresin në Kosovë, duke e sabotuar në forma të ndryshme rezultatin konkret të dialogut. Ka ardhur koha që të përkufizohet dialogu në një proces që duhet të vazhdojë me të gjithë fqinjët për t'i adresuar çështjet e hapura dhe se duhet ndihmë që transformimi i dialogut në negociatë të kthehet pikërisht në atë çfarë ka thënë edhe Rezoluta e Kombeve të Bashkuara pas vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, ku pavarësia e Kosovës njihet plotësisht si një akt, i cili nuk ka bërë asnjë kundërshti me Ligjin ndërkombëtar. Ai shtoi se Serbia sikur e ka shndërruar dialogun në një tentim për rinegociim të çështjeve të brendshme të Kosovës rrjedhimisht edhe të statusit. Ky zë në BE duhet të jetë shumë më i artikuluar sidomos pas zhvillimeve të fundit në Bosnje e Hercegovinë, ku shihet që strukturat mono etnike janë destruktive, sabotuese dhe të rrezikshme për sovranitetin dhe integritetin e shtetit të BeH, e që po shihet si një tendencë e njëjtë në vazhdimësi nga ana e Serbisë për të krijuar po këso struktura në Kosovë.

**Xhavit Haliti**, tha se nuk ka kosovarë që nuk është falënderues për të gjitha ato që i ka bërë Gjermania, qoftë për qytetarët e Kosovës që jetojnë në Gjermani, por në veçanti për Kosovën në përgjithësi.

Çështja e mungesës së investimeve nga Gjermania në Kosovë, tha se duhet të jetë brengë për të gjithë, duke pasur parasysh që Gjermania është superfuqi ekonomike e Evropës dhe duke i pasur parasysh lehtësirat dhe fuqinë punëtore të lirë në Kosovë. Lidhur me këtë, Haliti pyeti se a është çështje e korrupsionit, apo është në pyetje legjislacioni joadekuat për investitorë gjermanë dhe duhet ndryshuar, apo është diçka tjetër, ndërsa bëri të ditur se ka dëgjuar teza të ndryshme, veçanërisht sa i përket përpjekjes për të investuar në termoelektranat e Kosovës, por që për shkak të ligjeve të Kosovës, ka pasur një tërheqje strategjike nga ky investim i madh që ishte planifikuar.

Haliti kërkoi që Ambasada e Gjermanisë në Kosovë, ministrinë përkatëse të Kosovës si dhe Ambasada e Kosovës në Gjermani, të kenë një bashkëpunim të fuqishëm për t'i sjellë kompanitë serioze dhe të fuqishme në Kosovë, sepse çështje strategjike për Kosovën duhet të jetë qëndrimi në Kosovë i fuqisë punëtore dhe jo largimi i saj.

**Ariana Musliu-Shoshi**, falënderoi për ndihmën e madhe që Gjermania ia ka dhënë Kosovës, para se të ishte shtet, por edhe tash gjatë shtetndërtimit. Ajo tha se sipas disa artikujve që qarkullojnë në media, Kosova nuk është në agjendë të KE-së, që nuk është faji i Gjermanisë, por i disa vendeve tjera që e kanë njohur Kosovën, mirëpo, nuk pranojnë që Kosova të ketë liberalizimin e vizave. Musliu tha se Kosova

duhet ta ketë një strategji se si duhet t'i qaset këtyre shteteve të cilat janë njohëse të Kosovës, por që hezitojnë të japin dritën e gjelbër për liberalizimin e vizave. Lidhur me lëshimin e vizave nga Ambasada Gjermane, Musliu tha se i falënderon ata pasi që ambasada ka lëshuar viza me kohëzgjatje 3 – 5 vite dhe se kjo e bënë të ndihet mirë, pasi që dëshmohet se ambasada ka besim tek qytetarët që kanë një histori të pastër dhe njëkohësisht ua lehtëson jetën atyre. Ajo ngriti shqetësimin se aplikimi për termin në Ambasadën e Gjermanisë është shumë i vështirë, është një link, i cili hapet në orën 24:00 pas mesnate dhe jo të gjithë qytetarët e kanë mundësinë që të caktojnë termin për vizë. Tjetër shqetësim për të cilin tha se duhet të njoftohet ambasadori, është edhe shitja e terminëve dhe se kjo nuk i bënë nderë as ambasadës dhe as politikës gjermane sa i përket Kosovës, sepse duhet të ketë një kontroll më të madh kur është në pyetje termini për vizë.

**Dimal Basha**, tha se Kosova është mirënjohëse për kontributin e Gjermanisë dhe se këtë ajo nuk e harron dhe shprehu besimin se Gjermania gëzohet që i ndajmë vlerat e njëjta sot dhe se ajo mburret për një Kosovë demokratike që po vjen dhe po konsolidohet çdo ditë e më shumë.

Sa i përket investimeve gjermane, bëri të ditur se në qershor 2021 është raportuar se ka pasur rreth 33 milionë euro investime nga Gjermania që është një rritje, ndoshta më e madhe që nga viti 2011.

Lidhur me liberalizimin e vizave, Basha tha se Gjermania e ka përkrahur Kosovën në këtë proces, dhe se ka një aleancë të thellë me Francën dhe me Holandën, si dy shtete skeptike. Gjermania është shembulli më i mirë për të ndihmuar Kosovën për t'i bindur ato vende, për shkak se një prej problemeve që është shfaqur, është migrimi i madh i shqiptarëve në BE. Ai shtoi se Gjermania është shembull ku ka pranuar 1 milionë sirianë dhe sot i sheh si vlerë e shtuar dhe jo si problem. Kjo nuk do të ndodhë me Kosovën për shkak se 1.7 milionë qytetarë të Republikës së Kosovës nuk kanë për të emigruar në BE, pasi që Kosova ka arritur të konsolidohet. Basha bëri të ditur se është politikë e brendshme e shteteve të BE-së integrimi i refugjatëve brenda BE-së, por jo duke i ndarë dhe izoluar ata, kurse jo e njëjta praktikë po përdoret me Kosovën, e cila po izolohet dhe po kërkohet përmeshja e kushteve për t'i arritur standardet e BE-së.

Sa i përket dialogut, tha se ne dëshirojmë paqe dhe se Franca dhe Gjermania janë shembull të cilin Kosova mund ta ndjek, por duhet kuptuar se Kosova është ndoshta vendi i vetëm ku viktima kërkon paqe me agresorin. Ai shtoi se është pro bisedimeve, por disa çështje nuk duhet të bëhen vetëm për hir të bisedimeve, kjo për shkak se dialogu ka qenë një vegël e Serbisë, e cila vazhdon të bisedojë për tu vlerësuar si përmeshje e kriterëve. Këtu, tha se Gjermania duhet të ketë rol kyç, për të bërë shtytjen që të bisedohet një për marrëveshje përfundimtare.

Sa i përket hapësirave të ambasadës, Basha pyeti nëse Gjermania ka bërë ndonjë kërkesë për ta pasur një hapësirë për ndërtimin e ambasadës, e cila i plotëson të gjitha nevojat dhe nëse kjo është në shqyrtim.

**Jörn Rohde**, theksoi se nuk është e kuptueshme që për 1.5 milionë kosovarë të mos ketë liberalizim të vizave, ndërsa të ketë për disa milionë ukrainas, dhe se janë shumë të interesuar që të vijë liberalizimi shumë shpejt për Kosovën. Njëkohësisht, theksoi se me të drejtë thuhet se ka lëvizje politike të brendshme në disa shtete të BE-së dhe se zvarritet procesi i liberalizimit të vizave, e në këtë drejtim, tha se duhet të kontaktohen këto vende dhe të bisedohet me to.

Rohde, tha se liberalizimi i vizave për Kosovën do të vijë shpejt dhe se do të jetë shumë i lumtur nëse ndodh kjo. Sa i përket ndërtimit të ambasadës, tha se do të merr kohë edhe disa vite, por jo vetëm për shkak të kufizimeve nga pandemia. Lidhur me investimet, ai tha se Kosova e ka euron, është në Evropë, ka një diasporë shumë të madhe, 15% e popullsisë e flet gjuhën gjermane dhe ka parakushte ideale për investime. Ka pasur biseda sa i përket kushteve dhe kornizës ligjore për investime në Kosovë, por nëse një investitor ka probleme dhe shkon para gjykatës, duhet të shkojnë disa vite derisa ai problem të zgjidhet në gjykatë. Këto janë çështje që duhet të përmirësohen. Ai po ashtu ceku se edhe çështjet politike në Kosovë, të pasqyruara përmes televizioneve mund të lënë imazhe jo të mira për vendet e tjera të BE-së. Sa i përket dialogut, ai tha se duhet të ketë një platformë, ndërsa sa i përket investimeve, duhet të

jemi optimistë dhe së bashku t'i nxisim investitorët në Kosovë. Ai më tej theksoi se ambasadat e Kosovës jashtë vendit duhet të merren me diplomaci ekonomike dhe storiet e mira ekonomike që ekzistojnë në Kosovë duhet t'i përfaqësojnë jashtë. Duke pasur parasysh se Kosova ka në Gjermani një ambasadë dhe gjashtë konsullata, tha se secila konsullatë mundet që përveç çështjeve ditore që i ka, të merr edhe një detyrë të caktuar të cilën mund ta shpie përpara. Sa i përket çështjes së ngritur lidhur me shitjen e terminëve, njoftoi se janë duke punuar për të ndryshuar tërësisht sistemin e dhënies së terminëve.

**Bahrim Shabani**, pyeti ambasadorin lidhur me aplikimin e vizave, për të cilin tha se është një proces shumë i vështirë dhe se a ka ndonjë lëvizje se si të lehtësohet ky proces. Ka raste kur me muaj të tërë presin qytetarët për vizë për bashkim familjar. Ai po ashtu pyeti se në cilën fazë të procesit janë institucionet gjermane për pranimin e patentë shoferëve të Kosovës.

**Jörn Rohde**, lidhur me pyetjen për patentë shoferët, njoftoi se nga pala gjermane ka vetëm disa çështje administrative të cilat duhet të rregullohen, përndryshe parimisht ekziston një pëlqim i dyanshëm për njohje të patentë shoferëve. Sa i përket terminin të dhënies së vizave, njoftoi se gjatë pandemisë ka pasur një numër rekord të kërkesave për viza për bashkim familjar dhe për punonjës të kualifikuar, por sa i përket vizës për bashkim familjar nuk kërkohet kohë e gjatë e pritjes për tu pajisur.

**Haki Abazi**, falënderoi ambasadorin për përkrahjen e palës gjermane gjatë kohës së pandemisë, duke theksuar se në rast të pandemisë solidariteti në BE është i domosdoshëm për t'i tejkaluar këto situata të vështira. Ai njoftoi se kemi qenë të zotuar gjatë kësaj periudhe, që vetëm vaksinat që janë të pranuar dhe të licencuara nga BE-ja e ShBA-ja, të vijnë në Kosovë. Ai po ashtu falënderoi Gjermaninë për ndihmën e dhënë Kosovës për largimin nga blloku rregullues energjetik me Serbinë, që është një hap i rëndësishëm që ka bërë Kosova në krijimin e pavarësisë dhe menaxhimit të kufijve të vet energjetik. Më tej shtoi se ne jemi një prej shteteve me rezervat më të mëdha në Evropë me thëngjill, por tranzicioni energjetik është shumë i rëndësishëm nga ofiçienca deri tek investimet e kapaciteteve të energjisë së rinovuese. Gjermania me energji të rinovuese ka bërë një revolucion, e që sigurisht ky model është jashtëzakonisht i mirë për Kosovën dhe në këtë drejtim ne do të tentojmë të ecim me dinamikë të përshpejtuar, për të cilin edhe direktivat e BE-së, na obligojnë për brenda marrëveshjeve të përbashkëta. z. Abazi përmes ambasadorit i bëri ftesë Komisionit për Punë të Jashtme të Gjermanisë që të realizojë një vizitë në Kosovë, kurdo që të kenë mundësinë.

**Jörn Rohde**, tha se sa i përket çështjes së energjisë, Gjermania e ka ndihmuar financiarisht përmes KfW-së linjën në mes të Kosovës dhe Shqipërisë dhe është duke e dhënë edhe një mbështetje të mëtejme. Po ashtu njoftoi se kanë pasur rast që të përurojnë një impiant të ujërave të zeza, dhe se kanë pasur bisedime për projekte të tjera në fushën e energjisë, të mbeturinave dhe ujërave të zeza. Sa i përket transformimit të energjisë, Rohde njoftoi se ka vizituar impiantin e energjisë së erës në Bajgorë, që po implementohet me mjete gjermane dhe se pala gjermane ka deklaruar se Kosova ka potencial për prodhimin e energjisë, për të çuar përpara tranzicionin e energjisë. Ambasadori falënderoi për ftesën, duke bërë të ditur se të njëjtën, në formë të shkruar do ta përcjellë tek Komisioni për Punë të Jashtme në Bundestagun Gjerman.

Mbledhja përfundoi në orën 12:10.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Haki Abazi,  
Kryetar i Komisionit